

INFORMACION

Per situaten e ndotjes ne stacionet e monitorimit ne Tirane me stacionin e levizshem

1- Te dhenat e cilesise se ajrit 2015 ne stacionin e 21 Dhjetorit

Ne kuader te vlersimit te situates se ndotjes se ajrit urban ne qytetin e Tiranes eshte realizuar monitorimi i cilesise se ajrit ne dy 2 stacione. Ne periudhen 15-30.01.2015 eshte realizuar monitorimi me stacionin e levizshem ne kryqezimin e 21 Dhjetorit , stacioni ishte instaluar ne oborrin e prefektures me kordinata $4^{\circ} 19'34.36''N$ dhe $19^{\circ} 48' 12.82''E$ me distance 7 metra nga unaza dhe 37 m nga rruga e 21 Dhjetorit . Stacioni eshte I tipit trafik pasi ndodhet shume afer kryqezimit te 21 Dhjetorit dhe numri I makinave qe kalojne ne kryqezim eshte shume I larte dhe ne te shumten e rasteve me bllokim te trafikut. Monitorimi eshte realizuar 24 ore pa nderprerje per ndotesit kryesore te cilesise se ajrit si PM10,, NO₂, O₃, SO₂, CO,dhe Benzen

Nga te dhenat e monitoruara per periudhen 15-30.01.2015 rezulton sekemi nje nivel te larte ndotjeje ne kete zone e sidomos per ndotesit PM10. NO₂ , CO dhe Benzen qe kryesisht emetohen ne atmosphere si rezultat i shkarkimit te automjeteve.

☉ Niveli mesatar I PM10 ne kete stacion eshte 112 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ nga 40 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ qe eshte vlera limite e Standartit te BE. Kemi nje tejkalim te kesa vlere me 2.5 here (180%) . PM10 gjithashtu eshte nje ndotes qe pervec shkarkimit te automjeteve e ka burimin dhe nga pluhuri I rruges .

Nese do ti referohemi vlerave ditore ne 10 dite te monitoruara 8 dite tejkalojne vlerin limite ditore te standartit te BE qe eshte 50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$.

Te dhenat mesatare dhe ditore krahasuar me vleren limit e te Standartit te BE jane paraqitur dhe ne grafikun nr 1 dhe nr 2

☺ Persa I perket nivelit te SO₂ dhe O₃ mund te themi se nuk kemi tejkallim te vlerave limite te standartit te BE per te dy treguesit ne kete stacion . Kjo eshte e pritshme sepse SO₂ eshte nje ndotes qe shkarkohet ne atmosphere nga djegja e lendes djegse me permbajtje te lartre Squfurit si dhe nga procese natyrore si vullkanet etj. . Ozoni I shtresave te uleta te atmosferes krijohet ne temperature te larta dhe ne prani te rrezatimit diellor dhe ne kete rast ka dominuar I ftohti me temperature te uleta dhe reshje shiu . Gjithashtu ne stacionet e trafikut ozone eshte ne nivele te uleta per shkak te reaksioneve kimike ndermjet ozonit dhe monoksidit te azotit duke ndikuar ne rritjen e nivelit te NO₂.

☹ Referuar te dhenave te monitoruara gjate kesaj periudhe ne kete stacion kemi tejkallim te vlerave limite te standartit te BE per te dy ndotesit . Vlera mesatare e NO₂ ne stacionin e 21 Dhjetorit (prefektura) eshte 70.57 µg/m³ nga 40 µg/m³ qe eshte standarti I BE , pra kemi tejkallim ne masen 76% ose 1.7 here .


Po ashtu edhe per benzenin kemi tejkallim te vleres limite te standartit te BE dhe vlera mesatare e Benzenit per periudhen e monitoruar eshte 7.38 µg/m³ nga 5µg/m³ qe eshte standarti I BE , kemi tejkallim ne masen 47.6% ose 1.5 here.

Ne tabelen nr 1 jane dhene te dhenat ne vite t 2008-2011 dhe eshte po e njejta situatë me ndryshime te vogla por dhe periudha monitorimit kete vit eshte e shkurter per te gjykuar per nivelin e tejkallimeve te standartit te BE. .


Tabela 1 Te dhenat e 21 Dhjetorit ne vite

	PM10	SO ₂	NO ₂	O ₃	CO	Benzeni
	µg/m ³	µg/m ³	µg/m ³	µg/m ³	mg/m ³	µg/m ³
2008	104.91	20.63	51.75	46.54		
2009	143.13	16.78	49.64	41.3		
2010	106.42	24.07	46.08	55.69		
2011	81.45		56.8	19.26	0.56	
2015	112	19.85	70.57	11.63	1.79	7.38
Standarti I BE	40		40			5


Grafiku nr 3 Vlerat ditore te SO2




Grafiku nr 4 Vlerat orare te O3




Grafiku nr 5 Vlerat orare te CO




Grafiku nr 6 Vlera mesatare e NO2



Grafiku nr 7 Vlera orare te NO2



Grafiku nr 8 Vlera mesatare e Benzenit



1- Te dhenat e cilesise se ajrit 2015 ne stacionin e DSHP

Ne periudhen 30.01- 09.02. 2015 eshte realizuar monitorimi me stacionin e levizshem ne stacionin , stacioni ishte instaluar ne oborrin e drejtorise se Shendetit Publik Tirane kordinata 41° 19'19.57''N dhe 19° 49' 35.42''E me distance 90 metra nga rruga e Elbasani , (prane Liceut Artistik)dhe 3 m nga rruga dytesore qe kalon prane godines se DSHP . Stacioni eshte urban residencial , ndodhet larg rruges me trafik dhe gjithe zona eshte e gjelberuar me peme . Numri I makinave qe kalojne ne rrugen e Elbasanit eshte shume madh por drejtimi I eres gjate periudhes se monitoruar ka qene ne veri-perendim te Tiranës duke favorizuar levizjen e ndotjes ne drejtim te kundert te stacionit. Prandaj dhe niveli u ulet ne kete stacion eshte I ulet krahasuar me vlerat limite te te standartit te BE .

Nga te dhenat e monitoruara per periudhen 30.01- 09.02. 2015 rezulton se nuk kemi tejkallim te vlerave te monitoruar per asnje nga treguesit e monitoruar .


Gjithashtu po ti referohemi te dhenave ne vite vihet re se me perjashtim te PM10 I cili ka qene ne nivele te larta te gjithe treguesit e tjere jane nen vleren limite , tendence ne rritje ka patur NO2 por pa tejkalluar Standartin e BE

Po ti referohej nivelit te PM10 gjate periudhes se monitorimit shpjegohet dhe me faktin qe pervec drejtimet te eresh dhe reshjeve te shiut qe ne kete periudhe kane qene te dendura. Duke ndikuar ne pastrimin e ajrit urban.


Tabela 2 Te dhenat e DSHP ne vite

	PM10 µg/m3	NO2 µg/m3	SO2 µg/m3	O3 µg/m3	CO mg/m3	Benzeni µg/m3
2008		32.99	13.89	41.06		
2009		26.24	12.61	49.86	0.483	0.457
2010	81.55	24.73	15.23	47.81	0.479	
2011	73.21	34.49		28.1	1.536	0.397
2015	20.81	34.13	9.6	44.13	1.1	2.76
Standartii BE	40	40				5


Grafiku nr 10 Vlerat oraret e NO2




Grafiku nr11 Vlera orare te O3



Grafiku nr12 Vlera orare te CO



Grafiku nr13 Vlera orare te Benzenit



Tirane me 10.02.2015

